



**Republika e Kosovës
Komuna Drenas (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës**



12 Nr. 400-42750, dt. 31.08 2021

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40,40.2 nën b dhe c të ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34,pika 34.6, nën b dhe c të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe në bazë të nenit 8 të ligjit për Financat e Pushtetit Lokal 03/L-049 , Kuvendi i komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën **31.08.2021**, miratoi këtë:

VENDIM PËR RIDESTINIM TË MJETEVE

Neni 1.

Më këtë vendim,miratohet ridestnimi i mjeteve për shpenzime kapitale në programin buxhetor Drejtoria për Infrastrukturë Publike me kod buxhetor 18161 dhe kod funksional (0451)

Neni 2 .

Ridestnimi i mjeteve behët nga këto projekte kapitale me këto shuma :

1. **Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit “Fehmi e Xheva Lladrovci” me kod 49297 në shumë prej 150,000.00€**
2. **Hartimi i projektit të fizibilitetit për nxemjen qendrore me kod 49249 në shumë prej 50,000.00€**
3. **Mbikqyrja e projekteve kapitale ne KK Drenas me kod 48685 në shumë prej: 5,000.00€**
4. **Asfaltimi rruges Llapushnik Berishë me kod 49299 në shumë prej 5,000.00€**

Totali: 210,000.00€

Neni 3.

Ridestnimi i mjeteve nga neni 1 i këtij vendimi ridestinojnë në këto projektet kapitale:

1. **Rehabilitimi dhe Rikonstruimi i rrjetit të kanalizimit me kod 49189 në shumë prej: 40,000.00€**
2. **Asfaltimi i rruges në fshatin Sankoc dhe Fushticë me kod 48648 në shumë prej 15,000.00€**
3. **Asfaltimi i rrugës në fshatin Baicë, Krajkovë, Damanek me kod 48640 në shumë prej 40,000.00€**
4. **Asfaltimi i rrugës në fshatin Terstenik I dhe II me kod 48633 në shumë prej 10,000.00€**

5. Kanalizimi i ujërave të zeza dhe atmosferike Drenasin 1,2,3,4 me kod 48693 në shumë prej 20,000.00€
6. Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Abrin e Eperme Terdec me kod 48709 në shumë prej 10,000.00€
7. Asfaltimi i rrugës në fshatin Zabel i Ulet dhe Eperm, Korrotic e Ulet dhe Eperme me kod 48658 në shumë prej 20,000.00€
8. Rregullimi i infrastruktures trotuar dhe ndriqim publik në Komunën e Drenasit me kod 48617 në shumë prej 30,000.00€
9. Asfaltimi i rrugës Dobroshec, Çikatovë e Vjetër me kod 48638 në shumë prej 25,000.00€


Totali: 210,000.00€

Neni 4.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPLsi dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i Dergohet:



- Zyrës së Kryetarit
- Drejtorisë përkatëse
- Zyrës së Kuvendit
- Arkivit


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Labirnot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Radia i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers



Për:	Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
	Trim Berisha , Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Kopje:	Hekuran Murati , Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve
	Kryetari i Komunës së Drenasit
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve , Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Enis Spahiu , Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Klit Shala , Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	Elmedina Bajgora , Zyrtare e Lartë Ligjore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
L. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lenda:	Shqyrtimi i ligjshmërisë
Lloji i aktit:	Vendim

Inderuari Ministër z. Krasniqi,

Inderuari Sekretar i Përgjithshëm z. Berisha,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/1-05 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

<i>Vendimi 12 Nr. 400-42750 për ridestnim të mjeteve</i>
<i>I miratuar më datë 31.08.2021</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 01.09.2021</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 02.09.2021</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si “Ministria”), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës së Drenasit, vlerëson që akti i Komunës **nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm apo të rregullt të ligjshmërisë.**

Rregullorja (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, në përmbajtje të Shtojcës II, trajton aktet e organeve të komunës që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm apo të rregullt të ligjshmërisë. Në këtë kuptim, pika 34 e kësaj shtojce parasheh që vendimet për transferimin dhe rialokimin e ndarjeve buxhetore sipas nenit 30 të LMFPF, nuk i nënshtrohen konfirmimit të ligjshmërisë nga ministritë e linjës.

Në përmbajtje të vendimit komunal evidentohet se Komuna synon transferimin nga kategoria e rezervës në kategoritë ekonomike të shpenzimeve. Rrjedhimisht, duke pasur në konsideratë që akti komunal trajton transferimin e ndarjeve buxhetore, i njëjti nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të rregullta të shqyrtimit të ligjshmërisë, sikurse përcaktohet me pikën 34 të Shtojcës II në Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!